

**Analiza e bashkëjetesës ndëretnike në nivel lokal:
Indeksi i multikulturalizmit**

Botues:



Association for Democratic Initiatives

Autorët e analizës:

Risto Karajkov

Marija Dimitrovska



Përktheu: Xhemazije Rizvani

Dizajni: KONTURA

Tirazhi: 400 kopje



„Përbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e Asociacionit për iniciativa demokratike (ADI) dhe në asnjë mënyrë nuk mund të merret se i përfaqëson qëndrimet e Civica mobilitas, Agjencisë Zvicerane për zhvillim dhe bashkëpunim (SDC) ose organizatave që e implementojnë.”



МАКЕДОНСКИ
ЦЕНТАР ЗА
МЕЃУНАРОДНА
СОРАБОТКА



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC

Цивика мобилитас е проект на Швајцарската агенција за развој и соработка (СДЦ) кој го спроведуваат НИРАС од Данска, Македонскиот центар за меѓународна соработка (МЦМС) и ФЦГ Шведски развој АБ (ФЦГ Шведска)

**ANALIZA E BASHKËJETESËS
NDËRETNIKE NË NIVEL LOKAL**

INDEKSI I MULTIKULTURALIZMIT

Rezultatet nga hulumtimi

Dhjetor 2019
Gostivar

PËRMBAJTJA

HYRJE	7
1 INDEKSI I MULTIKULTURALIZMIT	8
1.1 QËLLIMI I KËRKIMIT DHE QASJA METODOLOGJIKE	9
2 KOMUNA E TETOVËS.....	16
2.1 PROFILI I KOMUNËS	16
2.2 INTEGRIMI DHE NDËRTIMI I KOMPETENCAVE NDËRKULTURORENË KUADËR TË SISTEMIT ARSIMOR	19
2.3 KULTURA	21
2.4 SHOQËRIA CIVILE DHE KOHEZIONI SOCIAL.....	22
2.5 PËRFUNDIMI: INDEKSI I VLERËSIMEVE DHE REKOMANDIMET	24
3 KOMUNA E BËRVENICËS	27
3.1 PROFILI I KOMUNËS	27
3.2 VETËQEVERISJA LOKALE DHE QASJA DERI TE SHËRBIMET PUBLIKE.....	29
3.3 INTEGRIMI DHE NDËRTIMI I KOMPETENCAVE NDËRKULTURORE NË SISTEMIN ARSIMOR	31
3.4 KULTURA	33
3.5 SHOQËRIA CIVILE DHE KOHEZIONI SOCIAL.....	33
3.6 PËRFUNDIM: INDEKSI I VLERËSIMEVE DHE REKOMANDIMET	35
4 KOMUNA E GOSTIVARIT	377
4.1 PROFILI I KOMUNËS	37
4.2 VETËQEVERISJA LOKALE DHE QASJA DERI TE SHËRBIMET PUBLIKE.....	39
4.3 INTEGRIMI DHE NDËRTIMI I KOMPETENCAVE NDËRKULTURORE NË KUADËR TË SISTEMIT ARSIMOR	40
4.4 EKZISTENCA E INSTITUCIONEVE / ORGANIZATAVE TË PËRKUSHTUARA NDAJ PROMOVIMIT TË MULTIKULTURALIZMIT PËRMES KULTURËS	43
4.5 SHOQËRIA CIVILE DHE KOHEZIONI SOCIAL.....	44
4.6 PËRFUNDIMI: INDEKSI I VLERËSIMEVE DHE REKOMANDIMET	477
5 KOMUNA E VRAPÇISHTIT	500
5.1 VETËQEVERISJA LOKALE DHE QASJA DERI TE SHËRBIMET PUBLIKE.....	522

5.2 INTEGRIMI DHE NDËRTIMI I KOMPETENCAVE NDËRKULTURORE NË KUADËR TË SISTEMIT ARSIMOR	533
5.3 KULTURA	544
5.4 SHOQËRIA CIVILE DHE KOHEZIONI SOCIAL	555
5.5 INDEKSI I VLERËSIMEVE DHE REKOMANDIMET	566

HYRJE

Zhvillimi i marrëdhënieve midis bashkësive etnike nënkupton një investim të vazhdueshëm institucional dhe personal në sferën e komunikimit ndërkulturor si dhe bashkëpunimit të qytetarëve të komuniteteve të ndryshme bashkë me institucionet.

Republika e Maqedonisë së Veriut si një vend që është angazhuar zyrtarisht për promovimin e të drejtave të komuniteteve të ndryshme për gati dy dekada, ka për borxh dhe detyrim të krijojë kushte të mundshme për zhvillimin e marrëdhënieve të pranimit, bashkëjetesës dhe bashkëpunimit midis komuniteteve.

Sidoqoftë, procesi i zhvillimit të mirëkuptimit multikulturor nuk është proces i njëanshëm dhe si i tillë kërkon refleksivitet të vazhdueshëm dhe analizë mbi ndikimin e politikave dhe iniciativave për bashkëjetesë.

Pas më shumë se një dekadë e gjysmë nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kornizë të Ohrit, është bërë e qartë se politikat për promovimin e të drejtave të komunitetit nuk duhet domosdoshmërisht të promovojnë bashkëjetesë dhe se pa zhvillimin e vazhdueshëm dhe të plotë të kapaciteteve ndërkulturore brenda komuniteteve, gjendja mund të pësojë regres deri në atë shkallë, sa të krijohet përçarje e shoqërisë. Ndarja e sistemin arsimor në të gjitha nivelet, e mbështetur për më shumë se një dekadë, ka filluar ngadalë të bjerë, dhe iniciativat e para për zhvillimin e kompetencave ndërkulturore mes nënësve brenda procesit mësimor, si dhe ndërtimi gradual i marrëdhënieve të afërsisë, janë iniciuar dhe zbatuar me dinamikë dhe intensitet të ndryshëm në të gjithë institucionet arsimore në vend. Për më tepër, nëpunësit e nivelit lokal - autoritetet lokale, institucionet publike dhe sektori privat, si dhe sektori civil, në mënyra të ndryshme dhe shkallë të ndryshme merren me këtë problematikë.

Qëllimi i këtij raporti është të paraqesë rezultatet e një hulumtimi mbi zhvillimin e marrëdhënieve midis bashkësive të ndryshme etnike në katër komuna të cilat janë të mbështetura dhe inkurajuar nga autoritetet lokale. Si pjesë e hulumtimit, u bë një përpjekje për të ndërtuar të ashtuquajturin Indeks të Bashkëjetesës Ndëretnike, si një mjet metodologjik, zbatimi i të cilit do të tejkalonte vëllimin e këtij studimi dhe do të lejonte një zbatueshmëri të gjerë për të analizuar marrëdhëniet midis komuniteteve në nivel lokal dhe monitorimin e tyre në periudha më të gjata kohore. Hulumtimi u realizua në kuadër të projektit Rrjetet Lokale për Multikulturalizëm, e implementuar nga Shoqata për Iniciativa Demokratike dhe e mbështetur nga programi Civica Mobilitas. Komunitat që mbulohen nga ky hulumtim si, Tetova, Bërvenica, Gostivari dhe Vrapçishti, përfaqësojnë mikro-mjedise specifike në të cilat zhvillohen marrëdhëniet midis bashkësive të ndryshme në ndikimin e faktorëve të ndryshëm si; shpërndarja demografike e popullatës, struktura etnike e vendbanimeve, madhësia dhe lloji i komunës (të mëdha dhe

urbane, përkundrejt të vogla dhe rurale), shkalla e zhvillimit të llojeve të ndryshme të institucioneve publike dhe shoqërisë civile, marrëdhënieve historike ndërkomunitare dhe të ngjashme. Për këtë arsye, ka qenë një sfidë e vërtetë për të zhvilluar një model që i përgjigjet specifikave të këtyre mjediseve dhe do të "matë" në mënyrë të duhur kushtet sipas kapaciteteve të komuniteteve, dhe nuk do t'i "ndëshkojë" ato për rrethana përtej ingerencave të tyre. Secila nga komunat e synuara ka një histori të gjatë të multikulturalizmit, në të cilën marrëdhëniet ndërkomunitare po zhvillohen për dekada dhe shekuj.

Rezultatet e paraqitura në kapitujt vijues analizojnë marrëdhëniet ndërkomunitare për një periudhë prej një viti. Përkatësisht, ideja që qëndron pas formulimit të këtij mjeti metodologjik - indeksi i multikulturalizmit, është që të mundësojë monitorimin e dinamikës së këtyre marrëdhënieve për një periudhë të gjatë kohore, por edhe të lejojë krahasimin midis komunave në bazë të kriterëve objektive. Kapitujt e mëposhtëm paraqesin rezultatet dhe përfundimet kryesore të hulumtimit.

Kapitulli i parë i është kushtuar prezantimit dhe shpjegimit të metodologjisë së kërkimit; Kapitulli i dytë deri te kapitulli i pestë, paraqesin rezultatet e hulumtimit me përfundime dhe rekomandime sa u përket komunave; Tetovë, Brvenicë, Gostivar dhe Vrapçisht.

1 INDEKSI I MULTIKULTURALIZMIT

Multikulturalizmi, si një fakt në shumicën e shoqërive, nënkupton angazhimin për ndërtimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit dhe kohezionit, si një hamendësim kyç për stabilitetin dhe përparimin e komuniteteve. Zhvillimi i këtyre marrëdhënieve paraqet një prioritet domethënës për mirëqenien dhe mbijetesën e shoqërive. Sidoqoftë, në dekadat e fundit, karakteri multikulturor i shoqërisë në Maqedoni, paraqet sfida të reja në ruajtjen e kohezionit të brendshëm. Në këtë kontekst, krijimi i kushteve për bashkëjetesë ndëretnike bëhet një kusht i rëndësishëm për ruajtjen e stabilitetit të brendshëm dhe zhvillimin e demokracisë në vend, ndërsa nevojitet identifikimi i fushave kryesore brenda të cilave duhet domosdoshmërisht ndërhyrja.

Zhvillimi i instrumenteve objektive dhe përkatëse për vlerësimin e zhvillimit të multikulturalizmit është një hap drejt zhvillimit të një kornize gjithëpërfshirëse për monitorimin e progresit të jetesës multikulturore në shumë fusha. Indekset paraqesin instrumente të përdorura gjerësisht, që lejojnë matjen objektive të fenomeneve të caktuara, identifikimin e zonave ku veprimi është i nevojshëm dhe krahasimin midis gjendjeve, sipas kriterëve objektive në komunitete të ndryshme. Në dekadat e fundit ka pasur një interes në rritje për aplikimin e indekseve për përcaktimin e shkallës së përparimit që komunitetet realizojnë në sfera të ndryshme të jetës. Ndër më të njohurit mund të përmendim Indeksën e Zhvillimit

Njerëzor, (Human Development Index), Lirinë e Shtypit, (Freedom of the Press) OECD Indeksi për jetë më të mirë (OECD Better Life Index) dhe të tjerë.

Në përpjekje për të siguruar njohuri objektive të fenomeneve komplekse, përveç metodave dhe të dhënave sasiore, studiuesit po zbatojnë gjithnjë e më shumë metoda dhe të dhëna cilësore. Indeksi është një instrument kompozit që grumbullon rezultate nga indikatorë të shumtë. Qëllimi i indekseve të kërkimit social është të përmbledhë dhe rendit vëzhgime specifike në një fushë të veçantë. Indikatorët janë karakteristika që mund të maten dhe vlerësohen si tregues objektivë të një aspekti të veçantë të realitetit shoqëror. Indeksi i multikulturalizmit paraqet një nga përpjekjet e para për të krijuar një mjet metodologjik objektiv për monitorimin e zhvillimit të marrëdhënieve ndërkomunitare në nivelin lokal. Metodologjia e elaboruar në shtojcën e këtij kapitulli kërkon të sigurojë zbatueshmërinë e metodës nëpër mjedise të ndryshme dhe të mundësojë monitorimin e gjendjeve të komunave në kohë të ndryshme.

1.1 QËLLIMI I KËRKIMIT DHE QASJA METODOLOGJIKE

Qëllimi i hulumtimit është të zhvillojë një indeks të multikulturalizmit dhe zbatimin e tij për të vlerësuar nivelin e marrëdhënieve ndëretnike në katër komunitat e synuara si; Tetovë, Bërvenicë, Gostivar dhe Vrapçisht.

Ky hulumtim është një nga përpjekjet e para për të analizuar sistematikisht zhvillimin e marrëdhënieve ndëretnike në vend, pra krijimin e një indeksi të multikulturalizmit, i cili do të sigurojë njohuri objektive për format e ndryshme të organizimit të marrëdhënieve midis bashkësive etnike.

Indekset si një masë kompozite e eksplorimit të gjendjeve komplekse, janë të manifestuara në fusha të ndryshme dhe janë të lidhura me bashkëveprimin e palëve të ndryshme të interesit, duke u bërë gjithnjë e më të rëndësishme në kërkimet sociale.

Indeksi i Multikulturalizmit është formuluar në nivel komunal. Në kuadër të këtij hulumtimi, janë përfshirë katër komuna me karakter multikulturor si: Tetova, Bërvenica, Gostivari dhe Vrapçishti.

Duke pasur parasysh kompleksitetin e subjektit të hulumtimit dhe rrethanat specifike për sa i përket të dhënave që ishin në dispozicion, u përdor një kombinim i metodave sasiore dhe cilësore për të kryer këtë hulumtim. Kjo qasje metodologjike është veçanërisht e dobishme në hulumtimin eksplorues (hulumtime që duhet të kenë njohuri paraprake për një situatë të caktuar), si dhe informacione më të thelluara mbi lëndën e interesit, veçanërisht nëse marrim parasysh që në fazën përgatitore të hulumtimit është konstatuar se për aspekte të ndryshme të veprimit të personave relevant ka pak qasje të dhënave publike.

Në fazën përgatitore të hulumtimit, u përcaktuan fushat kryesore që do të përfshihen në analizën e bashkëjetesës multikulturore në komunat e synuara. Më poshtë janë paraqitur katër fushat kryesore të përfshira në hulumtim:

- Pushteti vendor dhe aksesit deri te shërbimet publike
- Integrimi dhe ndërtimi i kompetencave ndërkulturore brenda sistemit arsimor
- Kultura
- Shoqëria civile dhe kohezioni social

Për secilën nga fushat e përmendura, është formuluar një grup indikatorësh, gjegjësisht tregues të shkallës së përbushjes së indikatorit. Bazuar në të dhënat e mbledhura brenda sondazhit, për secilin prej treguesve të listuar komunat janë vlerësuar në shkallët prej 1 deri në 7, ku shkalla 1 tregon se "indikatorit nuk është përbushur", ndërsa shkalla 7 tregon se "indikatorit është përbushur". Zgjedhja që gjendja të evaluohet në shtatë shkallë u bë për të vlerësuar më saktësisht situatën midis komunave. Indeksi përfundimtar i multikulturalizmit është mesatarja e vlerave të indikatorëve.

Sfera: Pushteti lokal dhe qasja deri te shërbimet publike

Indikatorit "respektohet korniza normative për respektimin e të drejtave të bashkësive etnike" synon të përcaktojë nëse dhe në çfarë mase pushteti vendor po aplikon ligjet që kanë të bëjnë me të drejtat e bashkësive etnike në nivelin lokal. Ky tregues u përpoq të përcaktojë nëse komuna ka themeluar një komitet për marrëdhënie ndërkomunitare (sepse është i obliguar me ligj ose me me vetëiniciativë) dhe funksionimin e tij (cila është përbërja e Komisionit (nëse ka anëtarë të Këshillit komunal, apo është i përbërë nga anëtarë të jashtëm) nëse mbahen takime, nëse respektohet korniza ligjore për konsultim me KMNB kur marrin vendime që prekin komunitetet etnike në nivelin lokal, nëse ndahen fonde për të mbështetur punën e KMNB-së, nëse investohet në kapacitetet e anëtarëve të KMNB- se dhe nëse ka bashkëpunim me palët e involvuara).

Në kuadër të këtij indikatorit insistohej që të vërtetohet nëse është respektuar korniza ligjore për përdorimin e gjuhëve të bashkësive etnike, si dhe përfaqësimin e bashkësive të ndryshme në organet komunale.

Indikatorit "autoritetet lokale dhe institucionet publike që punojnë në mënyrë aktive për të promovuar multikulturalizmin në nivel lokal" i referohet ekzistencës së strategjive, planeve dhe angazhimeve të tjera sistematike të autoriteteve lokale për të promovuar marrëdhëniet ndërkomunitare në nivel lokal, si dhe angazhimin për zbatimin e tyre.

Indikatorit "Ofrohet qasje e barabartë dhe cilësore në shërbimet publike për qytetarë të etnive të ndryshme" i referohet ekzistencës së një aksesit të barabartë në shërbimet publike për qytetarë të etnive të ndryshme.

Indikatorit "ekziston bashkëpunimi me nëpunësit në fushën e promovimit të multikulturalizmit" i referohet (mos)ekzistencës dhe shkallës së zhvillimit të

bashkëpunimit midis autoriteteve lokale me nëpunësit tjerë në fushën e promovimit të marrëdhënieve ndërkomunitare (sektori civil, institucionet arsimore, sektori I biznesit si dhe institucionet publike) përmes bashkëpunimit në projekte, duke ofruar mbështetje për aktivitetet e nëpunësve lokal në fushën e multikulturalizmit, konsultimit të nëpunësve në proceset e vendimmarrjes, ato të cilat janë me interes për problemin e marrëdhënieve ndërkomunitare, etj.

Sfera: Integrimi dhe ndërtimi i kompetencave ndërkulturore brenda sistemit arsimor

Indikatori "respektohet korniza normative për veprimtari mësimore me nxënës nga bashkësi të ndryshme etnike " i referohet përputhjes me kornizën ligjore për arsimin fillor, të mesëm dhe të lartë në kontekstin e të drejtës për arsimim në gjuhën amtare.

Indikatori "Zbatimi i qasjes arsimore ndëretnike të integruar" i referohet përputhjes së institucioneve arsimore vendore me angazhimet e Strategjisë së arsimit 2018-2025, si dhe përfshirjen dhe aktivitetet që realizohen në kuadër të projekteve të integritimit ndëretnik dhe arsimit të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

Indikatori "frekuenca dhe cilësia e ngjarjeve multietnike brenda dhe jashta procesit mësimor " i referohet aktiviteteve brenda dhe jashtë klasës që realizohen në institucionet arsimore të komunës dhe shërbejnë për të mbledhur nxënës nga bashkësi të ndryshme etnike, sa shpesh organizohen, çfarë aktivitetesh janë realizuar, cilat aktivitete zbatohen me iniciativën e vetë institucioneve arsimore dhe janë pjesë e detyrimeve ndaj MASH-it.

Indikatori "zbatimi i programeve për promovimin e multikulturalizmit" i referohet (mos) ekzistencës së programeve speciale të institucioneve arsimore që lidhen drejtpërdrejt me krijimin e marrëdhënieve midis nxënësve që u përkasin bashkësive të ndryshme etnike, ekzistimin e mjeteve për realizimin e këtyre programeve si dhe shkallën e realizimit të programeve

Indikatori "Angazhimi për zhvillimin e kompetencave ndërkulturore midis nxënësve të përfshirë në kuadër të procesit mësimor" i referohet (mos) ekzistencës së praktikës për përfshirjen e përmbajtjes dhe temave në fushën e marrëdhënieve ndërkomunitare, ndërtimin e ndjeshmërisë kulturore dhe kompetencave ndërkulturore brenda procesit mësimor. U kërkua të përcaktohej nëse ekzistonte një praktikë e tillë, sipas cilave lëndë si dhe nga kush kushtëzohet zbatimi i tij e të tjera.

Sfera: Kultura

Indikatori "ekzistimi i institucioneve / organizatave të përkushtuara për promovimin e multikulturalizmit përmes kulturës" i referohet (mos) ekzistencës së institucioneve (nën autoritetin e komunës, Ministrisë së Kulturës, institucioneve private ose

organizatave të shoqërisë civile) që zbatojnë aktivitete për promovimin e marrëdhënieve ndërkomunitare përmes kulturës dhe artit.

Indikatori "Frekuenca dhe cilësia e ngjarjeve kulturore / aktiviteteve / projekteve për krijimin e raporteve ndëretnike" i referohet numrit (sa shpesh ngjarje të tilla organizohen në nivel lokal) dhe llojit të aktiviteteve kulturore që synojnë thellimin e marrëdhënieve ndërkomunitare.

Indikatori "bashkëpunim midis organizatave / institucioneve në fushën e kulturës dhe nëpunësve tjerë vendorë në fushën e promovimit të multikulturalizmit" i referohet (mos) ekzistencës së bashkëpunimit midis institucioneve kulturore dhe palëve të tjera në nivelin lokal (autoritetet lokale, organizatat civile, bashkëpunimi me institucione nga anë të tjera të vendit, bashkëpunimi me komunitetin e biznesit) përmes projekteve të përbashkëta, mbështetje për organizimin e ngjarjeve kulturore, përfshirjen në proceset e vendim- marrjes.

Sfera: Shoqëria civile dhe kohezioni social

Indikatori "Angazhimi për projekte / aktivitete për promovimin e multikulturalizmit" i referohet (mos) ekzistencës së palëve të interesuara brenda sektorit të shoqërisë civile që në nivel lokal zbatojnë aktivitete për të promovuar marrëdhëniet ndërkomunitare, një shkallë të zhvillimit lokal të shoqërisë civile.

Indikatori "Frekuenca e aktiviteteve / projekteve / aktiviteteve për promovimin e multikulturalizmit" i referohet numrit (në nivel vjetor) dhe llojit të aktiviteteve dhe projekteve që realizohen nga sektori civil, të cilat janë të dedikuara për promovimin e multikulturalizmit në nivel lokal.

Indikatori "bashkëpunim nëpunës të rëndësishëm në nivelin lokal në fushën e zhvillimit të multikulturalizmit" i referohet (mos) ekzistencës së bashkëpunimit midis sektorit civil lokal me aktorët e tjerë të rëndësishëm në nivelin lokal (autoritetet lokale, institucionet arsimore, sektori i biznesit, institucionet kulturore) në fushën e veprimtarive për promovimin e multikulturalizmit, si dhe llojin e këtij bashkëpunimi (komunikimi, mbështetja e projektit,

Indikatori "Frekuenca dhe cilësia e komunikimit ndërkulturor midis komuniteteve" i referohet (mos) ekzistencës dhe llojit (nëse ekziston) të distancës sociale midis qytetarëve të bashkësive të ndryshme etnike në nivel lokal, shpeshësinë e kontakteve midis komuniteteve të ndryshme, llojin e kontakteve dhe komunikimit që realizohet midis qytetarëve të bashkësive të ndryshme etnike.

Fushat dhe treguesit janë paraqitur në shtojcën tabelare të këtij kapitulli:

Pushteti lokal dhe qasja deri te shërbimet publike	Respektohet korniza normative për respektimin e të drejtave të bashkësive etnike (funksionimi i Komisionit për marrëdhënie ndërkomunitare, zbatimi i kornizës ligjore për përdorimin e gjuhëve të ndryshme të bashkësive etnike)
----------------------------------------------------	----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

	Autoritetet lokale dhe institucionet publike punojnë në mënyrë aktive për të promovuar multikulturalizmin në nivelin lokal
	Sigurohet qasje e barabartë dhe cilësore për qytetarët e bashkësive të ndryshme etnike në shërbimet publike
	Ekziston bashkëpunim me nëpunësit tjerë në fushën e promovimit të multikulturalizmit
Integrimi dhe ndërtimi i kompetencave ndërkulturore brenda sistemit arsimor	Respektohet korniza normative për mësimdhënie me nxënës nga bashkësi të ndryshme etnike
	Aplikimi i qasjes së arsimit ndëretnik të Integruar
	Frekuenca dhe cilësia e mësimëve multi-etnike dhe veprimtarive jashtëshkollore
	Zbatimi i programeve për promovimin e multikulturalizmit
	Angazhim për zhvillimin e kompetencave ndërkulturore midis nxënësve, në kuadër të mësimdhënies
Kultura	Ekzistimi i institucioneve / organizatave të përkushtuara për promovimin e multikulturalizmit përmes kulturës
	Frekuenca dhe cilësia e ngjarjeve / aktiviteteve / projekteve kulturore për kohezionin ndëretnik
	Bashkëpunimi midis organizatave / institucioneve në fushën e kulturës dhe nëpunësve tjerë lokalë në fushën e promovimit të multikulturalizmit
Shoqëria civile dhe kohezioni social	Angazhimi me projekte / aktivitete për promovimin e multikulturalizmit
	Frekuenca e aktiviteteve / projekteve / aktiviteteve për promovimin e multikulturalizmit
	Ekzistimi i bashkëpunimit me nëpunësit tjerë të rëndësishëm në fushën e zhvillimit të multikulturalizmit në nivel lokal
	Frekuenca dhe cilësia e komunikimit ndërkulturor midis komuniteteve

Zgjedhja e metodave dhe teknikave për mbledhjen e të dhënave u përcaktua nga natyra e hulumtimit dhe rrethanat specifike të zbatimit të tij. Fenomeni i cili është objekt studimi është kompleks që manifestohet në zgjedhjen e metodave që mund të japin një pasqyrë të qartë në veprimtaritë e nëpunësve të ndryshëm. Për më tepër, zgjedhja e metodave ishte kushtëzuar edhe nga fakti se shumë pak të dhëna

për këto aktivitete janë në dispozicion të publikut, veçanërisht në lidhje me të dhënat sasiore të besueshme.

Në procesin e grumbullimit të të dhënave, janë analizuar informacionet e disponueshme publike (korniza ligjore, politikat lokale, dokumentet strategjike, programet e punës, raportet e fondeve të buxhetit, raportet speciale, etj.) nga autoritetet lokale, institucionet publike, organizatave civile dhe palëve tjera të interesuara. Për strukturën demografike të popullsisë në komunat e synuara janë përdorur të dhëna nga Zyra e statistikave shtetërore. Për më tepër, janë analizuar raporte speciale dhe lajme në lidhje me temën e hulumtimit.

Me qëllimin që të fitohen më shumë njohuri në veprimtaritë e institucioneve kyçe në nivel lokal, u realizuan intervista të detajuara me përfaqësues të disa institucioneve nga këndvështrimi i angazhimit të tyre në promovimin e marrëdhënieve ndëretnike.

Përzgjedhja e bashkëbiseduesve u kushtëzua nga vëllimi dhe cilësia e informacionit që mund të merrej nga bartësit e pozitave të ndryshme (kryesisht intervistat u realizuan me përfaqësuesit e lartë të institucioneve të përmendura¹). Intervistat e detajuara u realizuan me përfaqësues të njësisive të vetëqeverisjes lokale, institucioneve arsimore brenda komunës, ndërmarrjeve publike dhe komunitetit të biznesit, si dhe sektorit civil. Në procesin e mbledhjes së të dhënave, intervistat e detajuara u realizuan me 4-6 përfaqësues nga secila komunë.

Për të zgjeruar listën e bashkëbiseduesve midis palëve të interesuara përkatëse nga katër komunat e synuara, u realizua edhe një sondazh me pyetje të hapura dhe të myllura. Instrumenti për kryerjen e sondazhit përmban pyetjet e mëposhtme:

- pyetje në lidhje me kontekstin demografik në komunat e synuara;
- pyetje mbi politikat lokale, iniciativat dhe strukturat për të mbështetur dhe

zhvilluar bashkëjetesë multikulturore në nivelin lokal. Ky bllok pyetjesh përmbante nën-bloqe pyetjesh për grupet e ndryshme të nëpunësve, si: qeverisjes lokale, arsimin, shërbimit publik, shoqërisë civile, biznesit, kulturës;

- pyetje që eksplorojnë shkallën e zhvillimit të kompetencave ndërkulturore, barazinë, mosdiskriminimin dhe pjesëmarrjen e të anketuarve.

Pyetësi përmban pyetje të tipit të hapura dhe të mbyllura. Duke pasur parasysh përvojat e vetë-plotësimit të një pyetësi të anketës me pyetje të hapura (përgjigjet shmangen ose jepen përgjigje të shkurtra) ky pyetësor u realizua me përfaqësues të institucioneve përmes telefonit, aktivitetet e të cilëve u përfshinë në studim. Në varësi të numrit të palëve të identifikuara, janë anketuar 4-6 përfaqësues të institucioneve në secilën komunë.

¹Institucionet që janë kontaktuar për qëllimin e këtij studimi nga komuna janë paraqitur në Shtojcën 1, në fund të këtij dokumenti.

Më në fund, për të përcaktuar perceptimet e qytetarëve në lidhje me marrëdhëniet ndërmjet bashkësive të ndryshme etnike, u implementua një pyetësor i vogël (20 të anketuar për komunë) nga komunat e studiuara. Anketa me qytetarë nuk kishte për qëllim verifikimin e përfaqësimit të perceptimeve sipas profilit demografik të bashkisë, por përkundrazi për të identifikuar tendencat kryesore midis qytetarëve të bashkësive të ndryshme etnike, si dhe për të siguruar një pasqyrë se si ndikojnë aktivitetet e nëpunësve të ndryshëm në nivel lokal. Ky pyetësor studimor, i cili kryesisht përbëhej nga pyetje të tipit të mbyllura, përfshinte pyetje për distancën sociale, llojet e ndërveprimit me përfaqësuesit e komuniteteve të tjera, (mos) njohjen dhe / ose (mos) pranimin e diversitetit kulturor.


Procesi i mbledhjes së të dhënave u zhvillua në nëntor dhe dhjetor të vitit 2019.

Të dhënat e anketës u futën në një bazë të dhënash dhe u përpunuan me statistika. Të dhënat e marra përmes pyetjeve të hapura iu nënshtruan një analize cilësore. Rezultatet e indeksit bazoheshin në mendimet e dy ekspertëve që kryenin studimin. Kriteret për të bërë vlerësimet e indeksit i nënshtroheshin harmonizimit, dhe vlerësimet përfundimtare në indeks u vendosën me konsensusin e studiuesve. Kapitujt e mëposhtëm prezantojnë njohuritë bazë për komunat e studiuara dhe rezultatet kryesore sipas zonave dhe indikatorëve të analizuar. Secili kapitull përmban vërejtje përfundimtare në të cilat indikatorët paraqiten dhe indeksohen me vlerësime dhe rekomandime.

2 KOMUNA E TETOVËS

2.1 PROFILI I KOMUNËS

Komuna e Tetovës është e vendosur në rajonin e Pollogut dhe është një nga komunat më të mëdha në vend. Komuna e Tetovës është një komunë multi-etnike me një popullësi prej 86.580, sipas regjistrimit të vitit 2002 - 60.886 shqiptarë, 20.053 maqedonas, 1.882 turq, 2,357 romë dhe 1.415 të tjerë.



Qendra e komunës është qyteti i Tetovës, një mjedis multietnik ku qytetarët kanë përkatësi të ndryshme fetare dhe etnike, por megjithatë për një kohë të gjatë jetojnë së bashku.

Siç shihet nga harta e shpërndarjes së përkatësisë etnike, me përjashtim të qytetit të Tetovës, shumica e vendbanimeve janë etnikisht homogjene, gjë e cila thekson rëndësinë e qytetit të Tetovës si një mjedis për bashkëveprimin dhe kohezionin e qytetarëve me prejardhje të ndryshme etnike.

Figura 2. Shpërndarja etnike e popullatës në vendbanimet e Komunës së Tetovës.²



2.1.1 VETËQEVERISJA LOKALE DHE QASJA NË SHËRBIMET PUBLIKE

2.1.2 Respektohet korniza normative për respektimin e të drejtave të bashkësive etnike

Komuna e Tetovës menaxhohet nga një kryetar dhe një këshill prej 31 këshilltarësh. Gjuhët zyrtare të komunës janë maqedonishtja dhe shqipja.

Nga të dhënat në faqen e komunës u pa se të gjitha informatat ishin të disponueshme në të dy gjuhët. Në pajtim me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale³(2004), komunat në të cilat të paktën 20% e popullsisë i përkasin një komuniteti etnik të pakicave e kanë për detyrim të krijojnë një Komision për Marrëdhënie Midis Bashkësive.

² Burimi: Harta demografike e Komunës së Tetovës në maqedonisht, në likun poshtë:https://mk.wikipedia.org/wiki/%D0%9E%D0%BF%D1%88%D1%82%D0%B8%D0%BD%D0%B0_%D0%A2%D0%B5%D1%82%D0%BE%D0%B2%D0%BE#/media/%D0%9F%D0%BE%D0%B4%D0%B0%D1%82%D0%BE%D1%82%D0%B5%D0%BA%D0%B0:Ethnic_groups_of_Tetovo_Municipality.svg. Kërkojmë ndjesë por hartat demografike ekzistojnë vetëm në gjuhën maqedone dhe është I pamundur intervenimi mbi to.

³Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" Nr. 5, 29 Janar 2002)

KMNB e Komunës së Tetovës përbëhet nga 7 anëtarë, përfaqësues të komuniteteve të ndryshme që jetojnë në komunë.

Anëtarët e KMNB-së në Tetovë nuk zgjidhen nga këshilltarët, por të gjithë anëtarët janë anëtarë të jashtëm. Nga të dhënat e marra përmes një studimi dhe bisedave me përfaqësuesit e vetëqeverisjes lokale dhe KMNB-së, mund të konkludohet se funksionimi i KMNB-së është më shumë formal se funksional.

Buxheti komunal nuk ndan fonde të veçanta për të mbështetur punën e KMNB-së, dhe komuna nuk është në gjendje të sigurojë as hapësira për të lehtësuar funksionimin e këtij organi. Është konstatuar pakënaqësia ndaj trajtimit të këtij organi, mendimet e të cilit nuk janë të rëndësishme për Këshillin Komunal. Anëtarët e KMNB-së bashkëpunojnë me nëpunësit tjerë të nivelit lokal, kryesisht me sektorin civil, dhe marrin pjesë në aktivitete për ndërtimin e kapaciteteve. Sidoqoftë, ekziston një mendim mbizotërues se pikërisht statusi jo obligativ i vendimeve të KMNB-së ka një ndikim thelbësor në mungesën e mbështetjes së këtij organi.

2.1.2 Autoritetet lokale dhe institucionet publike punojnë në mënyrë aktive për të promovuar multikulturalizmin në nivel lokal

Si rezultat i bashkëpunimit me sektorin e shoqërisë civile, Komuna e Tetovës ka miratuar një plan strategjik për promovimin e mirëkuptimit ndërkulturor. Plani Strategjik parashikon një fokus të veçantë në aktivitete që promovojnë multikulturalizmin në fushën e kulturës, arsimit, sportit, si dhe forcimin e institucioneve ekzistuese në mënyrë që të zhvillojnë marrëdhëniet e bashkëjetesës midis komuniteteve.

Komuna ishte e informuar për strategjinë e miratuar për promovimin e mirëkuptimit multikulturor. Ai plan u miratua këtë vit, megjithëse nuk është postuar në faqen e internetit të komunës dhe ka një vlefshmëri pesë vjeçare. Për shkak të faktit se dokumenti strategjik ka hyrë në fuqi këtë vit, bashkëbiseduesit nuk mund të japin informacion për nivelin e zbatimit të aktiviteteve të planit në veprim.

Sipas bashkëbiseduesve, plani ka të bëjë kryesisht me monitorimin me zbatimin e tij në shkolla dhe komunë. Bashkëbiseduesit deklaruan se, megjithëse komuna ka ide se si të përmirësohet më tej bashkëjetesa ndëretnike (kryesisht duke u përqëndruar në rininë dhe sistemin arsimor) problemi kryesor për zbatimin e këtyre ideve është mungesa e fondeve.

2.1.3 Ekziston bashkëpunimi me nëpunësit tjerë në fushën e promovimit të multikulturalizmit

Këto nisma mbështeten indirekt nga sektori i shoqërisë civile përmes konkurseve vjetore për financimin e projekteve në fusha të ndryshme (kulturë, sport, mbrojtje

sociale). Brenda buxhetit për vitin 2019 të publikuar në faqen e internetit të komunës, kostot e vlerësuara ishin 9 milion denarë.⁴

Informacionet mbi thirrjet për dhënien e ndihmës financiare për organizatat civile publikohen në webfaqen e komunës. Komuna e Tetovës ka bërë thirrje që organizatat civile të aplikojnë për projekte për vitin 2019, por shumta e fondeve të ndara në këtë thirrje nuk është e specifikuar. Në webfaqe nuk jepen informacione edhe për projektet që mbështeten, kështu që nuk mund të përcaktohet se deri ku lëviz shumta e projekteve që merren drejtpërdrejt me promovimin e marrëdhënieve ndërmjet bashkësive etnike.

Sa i përket bashkëpunimit të autoriteteve lokale me nëpunësit përkatës në nivelin lokal, përfaqësuesit e komunës së Tetovës shprehen të kënaqur, duke sugjeruar që nevojitet mbulim më i madh nga mediat për aktivitetet që synojnë promovimin e multikulturalizmit.

2.2 INTEGRIMI DHE NDËRTIMI I KOMPETENCAVE NDËRKULTURORENË KUADËR TË SISTEMIT ARSIMOR

Në suaza të Komunës ka disa shkolla fillore dhe të mesme, si dhe dy universitete.

Shkollat fillore:

- Shkolla Fillore "Besa"
- Shkolla fillore "Përparimi"
- Shkolla Fillore Rexhep Voka
- Shkolla Fillore "Rilindja"
- Shkolla Fillore "Skenderbeu"
- Shkolla fillore "Andrea Savevski-Kikish"
- Shkolla Fillore "Kirili dhe Metodij"
- Shkolla fillore "Naim Frashëri"
- Shkolla Fillore "Goce Delçev"
- Shkolla Fillore "Istikball"
- Shkolla Fillore "Liria"
- Shkolla Fillore "Bratstvo-Migjeni"

Shkollat e mesme:

- Shkolla e Mesme "Goce Stojčevski"
- Shkolla e Mesme "Mosha Pijade"
- Shkolla e Mesme "Nikolla Shtejn"
- Shkolla e Mesme "Kiril Pejčinovic"

⁴Buxheti i Komunës së Tetovës për vitin 2019:

<https://www.tetova.gov.mk/docs/buxhet2019m.pdf>

- Shkolla e Mesme “8 Shtatori”

Brenda komunës ka dy universitete:

- Universiteti i Tetovës dhe

- Universiteti i Evropës Juglindore.

2.2.1 Respektohet korniza normative për mësimdhënie me nxënës nga bashkësi të ndryshme etnike.

Bashkëbiseduesit nga sektori i arsimit na informuan se megjithëse marrëdhëniet ndërkomunitare janë përgjithësisht të qëndrueshme (jo të shkëlqyera), zhvillimet e përditshme politike kanë një ndikim në afërsinë midis komuniteteve të ndryshme. Në shumicën e shkollave të komunës mësimi zhvillohet në disa gjuhë mësimore (shqip dhe maqedonisht). Sidoqoftë, ka ngjarje të ndryshme në shkollë në lidhje me mundësinë që nxënësit të takohen dhe të socializohen. Në shkollën fillore “Kirili dhe Metodij”, nxënës nga bashkësi të ndryshme etnike mësojnë në të njëjtën ndërtësë dhe në ndërrime të përziera. Kjo nuk është shprehur në shumë shkolla, ku ndërrimet shkollore janë të organizuara sipas gjuhës në të cilën zhvillohet mësimi.

2.2.1 Frekuenca dhe cilësia e veprimtarive mësimore multietnike dhe aktiviteteve jashtëshkollore

Bashkëbiseduesit thanë që në kurrikulën e lëndëve të ndryshme mësimi i integruar është i detyrueshëm. Kjo realizohet duke bashkuar klasa nxënësish nga bashkësi të ndryshme etnike. Për më tepër, aktivitete të tilla organizohen në festimin e patriotit të shkollës si dhe festave të tjera, me ç’rast nxënësit paraqesin aspekte të ndryshme të kulturës së tyre.

2.2.2 Zbatimi i programeve për promovimin e multikulturalizmit

Byroja për zhvillimin e arsimit parashikon një program të detyrueshëm për nxitjen e integritit ndërkulturor midis nxënësve. Disa nga bashkëbiseduesit deklaruan se ky proces kryesisht u lihet vetë mësuesve, përgjegjësia e të cilëve është të identifikojnë përmbajtje që mund të jenë të përshtatshme për mësimdhënie të integruar. Në disa shkolla nxënësit kanë seksione të përbashkëta (art, dramë) dhe marrin pjesë në garat sportive.

2.2.3 Angazhimi për zhvillimin e kompetencave ndërkulturore të nxënësit, në kuadër të procesit mësimor

Në lidhje me nivelin e angazhimit për zhvillimin e kompetencave ndërkulturore midis nxënësve, bashkëbiseduesit shprehen të kënaqur me shkallën e integritetit një fenomen të tillë në kuadër të mësimi të rregullt dhe theksuan se kjo komponentë paraqet një pjesë integrale të planeve vjetore të shkollës.

Në disa shkolla, siç është shkolla fillore "Kiril Pejcinoviç", janë futur si lëndë gjuhët e bashkësive të ndryshme që nxënësit t'i mësojnë, që është një nga hapat për të kapërcyer pengesat gjuhësore midis nxënësve nga komunitete të ndryshme. Thjesht është theksuar nevoja për një bashkëpunim më të madh mes shkollave nga pjesët e tjera të vendit, veçanërisht mes shkollash me nxënës etnikisht homogjen, në mënyrë që të ndërtohet bashkëpunimi përmes aktiviteteve të përbashkëta të nxënësve për njohjen e tyre të ndërsjellë.

2.3 KULTURA

2.3.1 Ekzistenca e institucioneve / organizatave të përkushtuara për promovimin e multikulturalizmit përmes kulturës

Në fushën e kulturës brenda komunës ka disa institucione:

- Institucioni i Qendrës Kombëtare të Kulturës
- Galeria e artit pamor Tetovë
- Biblioteka "Koço Racin"
- Teatri i Tetovës

Brenda institucioneve të kulturës, bashkëpunimi midis bashkësive të ndryshme zhvillohet pa probleme. Sidoqoftë, duhet të theksohet se ky bashkëpunim është i kushtëzuar pjesërisht nga vlera e fondeve në buxhetet e institucioneve kulturore, të cilat ndryshojnë. Duhet theksuar se politikat në nivelin qendror gjithashtu kanë një ndikim në këtë drejtim pasi disa nga institucionet në fushën e kulturës financohen nga buxheti i komunës, ndërsa Qendra për Kulturë, si institucion kombëtar, financohet nga Ministria e Kulturës.

Studioja e Baletit në Qendrën e Kulturës operon me grupe etnike të përziera. Klubi letrar funksionon gjithashtu me një etni të përzier.

2.3.2 Frekuenca dhe cilësia e ngjarjeve / aktiviteteve / projekteve kulturore për marrëdhënie ndëretnike

Sidoqoftë, nuk ka projekte specifike që adresojnë në mënyrë specifike këtë qëllim, d.m.th. të insistohet që të arrihet një afërsi më e madhe e bashkësive brenda aktiviteteve të rregullta të Qendrës. Aplikimet për projekte të këtij lloji janë dërguar në Ministrinë e Kulturës, por deri më tani nuk kanë marrë mbështetje për idetë e tyre.

Arsyetimi është se relativisht shpesh (disa herë në vit) organizohen ngjarje kulturore në Komunë, ku marrin pjesë artistë me prejardhje të ndryshme etnike.

2.3.3 Bashkëpunimi midis organizatave / institucioneve në fushën e kulturës dhe nëpunësit tjerë lokalë në fushën e promovimit të multikulturalizmit

Financat theksohen si një sfidë kryesore për investime më të mëdha në ngjarje kulturore dhe aktivitete që do të shërbejnë për thellimin e marrëdhënieve midis bashkësive të ndryshme etnike. Për më tepër, financat janë gjithashtu një pengesë për organizimin më të mirë të ngjarjeve aktuale, gjegjësisht krijimin e kushteve për takim dhe bashkëpunim ndërmjet pjesëmarrësve, e cila në të kundërt përfundon me përfundimin e performancës. Bashkëpunimi dhe koordinimi i mëtutjeshëm ndërmjet palëve të interesuara në nivel lokal dhe qendror, do të lejonte sasi dhe cilësi më të madhe të nismave kulturore.

2.4 SHOQËRIA CIVILE DHE KOHEZIONI SOCIAL

2.4.1 Angazhimi për projekte / aktivitete për promovimin e multikulturalizmit / Ekzistencës së bashkëpunimit me nëpunësit tjerë të rëndësishëm në nivel lokal në fushën e zhvillimit të multikulturalizmit

Brenda komunës ka disa organizata të shoqërisë civile që punojnë për afrimin e bashkësive të ndryshme etnike. Disa nga këto organizata zbatojnë aktivitete me mbështetjen e pushtetit vendor por edhe me mbështetjen e organizatave të huaja. Intervistat dhe pyetëtori i anketës që u realizua me një pjesë të sektorit të shoqërisë civile në komunë shprehën kënaqësi të moderuar nga financat të dedikuara për thellimin e multikulturalizmit. Disa na treguan se në kushte kur nuk ka konflikte të dukshme midis bashkësive etnike, temat që lidhen me marrëdhëniet ndëretnike nuk zënë vend në agjendën e donatorëve.

2.4.2 Frekuenca e aktiviteteve / projekteve për promovimin e multikulturalizmit

Organizatave civile theksuan se bashkëpunimi me KMNB-në e Komunës së Tetovës është pothuajse jo ekzistent dhe shprehën pakënaqësi për nivelin e gatishmërisë për bashkëpunim dhe proaktivitetin e këtij organi në fushën e marrëdhënieve ndëretnike në komunë. Bashkëpunimi me shkollat ishte i kënaqshëm gjë që është realizuar me iniciativën e të dyja palëve. Sa i përket mënyrës se si zhvillohen marrëdhëniet ndërmjet bashkësive etnike, të anketuarit thane se raportet mbeten kryesisht të njëjta, por një përqindje po aq e lartë thanë se këto marrëdhënie janë përmirësuar gjatë vitit të kaluar. Si pjesë e sondazhit të qytetarëve, u analizuan qëndrimet e të anketuarve për të mësuar një gjuhë në një komunitet tjetër. Për shumicën e të anketuarve kjo është çështje zgjedhjeje, ndërsa një numër i vogël e konsiderojnë të detyrueshme. Sidoqoftë, një e katërta e qytetarëve konsiderojnë

se njohja e gjuhëve të komuniteteve të tjera është e panevojshme. Më shumë se dy të tretat e të anketuarve besojnë se bashkëjetesa dhe bashkëpunimi paqësor drejtohen nga komuna; megjithatë, një e katërta e të anketuarve u përgjigjën se këto marrëdhënie ishin të përmbajtura dhe madje armiqësore.

2.4.3 Frekuenca dhe cilësia e komunikimit ndërkulturor midis komuniteteve

Një përqindje shumë e vogël e të anketuarve thanë se në jetën private shoqërohen çdo ditë me njerëz nga etnitë tjera; më shpesh ndërveprimi zhvillohet në vendin e punës ose për çështje që prekin komunitetin.

Megjithëse bashkëbiseduesit e sektorit të arsimit shprehën të kënaqur me përpjekjet e bëra deri më tani për të përafruar të rinjtë nga bashkësi të ndryshme etnike, ata theksuan se kur u realizuan aktivitete të përbashkëta kishte akoma disa kufizime, në të cilat roli i nxënësve ishte të paraqisnin veçantitë e kulturës së tyre si dhe festat që lidhen me grupin e tyre etnik, mirëpo kryesisht nuk u përfshin në ritualet e një grupi tjetër etnik.

Problemet e investimit në aktivitetet e integruara dhe zbatimi i angazhimeve të integrimit ndëretnik në arsim janë kryesisht financiare dhe organizative. Organizative për sa i përket faktit se shumica e shkollave nuk kanë kapacitete hapësinore të përshtatshme për organizimin e mësimdhënies së integruar. Financiarisht, problemet lidhen me mungesën e fondeve dhe nevojat themelore të shkollave. Përkatësisht, krahasuar me komunat e tjera që janë pjesë e hulumtimit, shkollat në komunën e Gostivarit janë në rrethana të veçanta për shkak të marrëdhënieve të ndërprera midis autoriteteve lokale dhe qendrore, gjë që ka sjell veçanërisht reagime në institucionet arsimore.

4.3.4 Angazhimi për zhvillimin e kompetencave ndërkulturore të nxënësve gjatë procesit mësimor

Përshtypja e bashkëbiseduesve ishte se në disa shkolla përkundër rrethanave dhe mundësive specifike të ofruara nga programi Nansen, përfshirja e mësuesve në aktivitete për të forcuar kompetencat ndërkulturore të nxënësve varet kryesisht nga motivimi dhe interesi personal. Këto janë përgjithësisht të ulëta, për një sërë arsyesh - paga të ulëta, mbingarkesë me detyra administrative, kufizime hapësinore, pozicioni i degraduar i kuadrit mësimor. Këtu bashkëbiseduesit panë edhe arsyen kryesore për interesin e dobët të sektorit të biznesit vendor për të përmbushur mbështetje financiare për aktivitetet e multikulturalizmit.

Shkollat kanë një program për integrim ndëretnik, por aktivitete, posaçërisht orë mësimore zhvillohen rrallë, për për shkak të mbingarkesës së nxënësve (këto janë aktivitete jashtëshkollore të kryera pas orëve të rregullta). Bashkëbiseduesit shprehën nevojën që këto aktivitete të jenë pjesë e klasës së rregullt, duke bërë kështu që vetë nxënësit të jenë më të motivuar për të marrë pjesë.

4.4 EKZISTENCA E INSTITUCIONEVE / ORGANIZATAVE TË PËRKUSHTUARA NDAJ PROMOVIMIT TË MULTIKULTURALIZMIT PËRMES KULTURËS

Brenda komunës së Gostivarit ka dy institucione kulturore:

- Qendra Kulturore "ASNOM", institucion nacional
- Galeria "Kult", një institucion privat kushtuar promovimit të artit.

4.4.1 Frekuenca dhe cilësia e ngjarjeve / aktiviteteve / projekteve kulturore ndëretnike

Megjithëse përfaqësuesit e institucioneve përkatëse që ishin pjesëmarrëse në anketim shprehen të kënaqur me cilësinë e ofertës kulturore të komunës, bashkëbiseduesit tjerë shprehën një nivel të ulët të kënaqësisë me të dhe angazhimin e institucioneve kulturore në promovimin e bashkëjetesës ndëretnike.

4.4.2 Bashkëpunimi midis organizatave / institucioneve në fushën e kulturës dhe nëpunësit tjerë lokalë në fushën e promovimit të multikulturalizmit

Bashkëbiseduesit në fushën e kulturës deklaruan se nuk ka mundësi kryesore financiare për organizimin e projekteve që do të synojnë drejtpërdrejt promovimin e bashkëjetesës ndëretnike në nivelin lokal. Aktivitetet e implementuara synojnë

të sigurojnë pjesëmarrje dhe bashkëpunim midis të gjitha komuniteteve në komunë. Mbështetja në dispozicion është pak e rrallë, si në nivel lokal ashtu edhe në atë qendror. Bashkëpunimi ndërinstucional ekziston, por kryesisht në shpërndarjen e hapësirës dhe rekuizitave, kryesisht për shkak të problemeve financiare me të cilat përballen institucionet kulturore.

4.5 SHOQËRIA CIVILE DHE KOHEZIONI SOCIAL

4.5.1 Angazhimi për projekte / aktivitete për promovimin e multikulturalizmit

Brenda komunës veprojnë disa organizata të shoqërisë civile, prej të cilave disa kanë ndarë pikëpamjet e tyre dhe kanë kontribuar me informacion mbi aktivitetet e sektorit të shoqërisë civile në komunë për të promovuar mirëkuptimin ndërkulturor. Disa organizata qytetare në komunë vazhdimisht po zbatojnë nisma për të promovuar multikulturalizmin në nivelin lokal.

Asociacioni për Iniciativa Demokratike (ADI) është një organizatë e cila ka për qëllim strategjik promovimin e marrëdhënieve ndëretnike midis bashkësive të ndryshme në komunë. Për më shumë se dy dekada, "ADI" ka implementuar një sërë nismash për të promovuar bashkëjetesën ndëretnike në komunë, përmes bashkëpunimit me autoritetet lokale për të ndërtuar politika lokale që përfshijnë dhe promovojnë konceptin e multikulturalizmit, duke forcuar vazhdimisht kapacitetet e KMNB-së së Gostivararit, organizimin e trajnimeve për të drejtat e njeriut dhe të pakicave me nëpunës të ndryshëm lokalë (përfaqësues të shoqërisë civile, gazetarë, përfaqësues të institucioneve publike, komunitetit të biznesit), si dhe monitorimit të vazhdueshëm të zhvillimit të marrëdhënieve ndërmjet komuniteteve përmes hulumtimeve dhe analizave. Në fokus të aktiviteteve në fushën e kohezionit ndëretnik janë rinia me ç'rast organizata ka realizuar disa projekte që synojnë ndërtimin e kompetencave ndërkulturore dhe promovimin e mirëkuptimit ndërkulturor midis të rinjëve nga bashkësi të ndryshme etnike në komunë.

Në kuadër të aktiviteteve të organizatave tjera civile në komunë, bashkëbiseduesit na informuan se disa OJQ lokale në bashkëpunim me UNDP kanë implementuar një projekt për integrim ndëretnik përmes sportit. Komuna e Gostivarit edhe vetë merr pjesë me mbështetje financiare për funksionimin e Qendrës Rinore.

4.5.2 Frekuenca e aktiviteteve për promovimin e multikulturalizmit

Komuna vazhdimisht organizon aktivitete të ndryshme që synojnë promovimin e marrëdhënieve ndëretnike. Këto aktivitete variojnë nga zhvillimi i bashkëpunimit midis palëve të interesuara lokale, iniciativave rinore, organizimit të ngjarjeve kulturore dhe sportive dhe aktiviteteve arsimore. Ajo që kanë shprehur nëpunësit

përkatës të sektorit të shoqërisë civile është nevoja për vazhdimësinë e këtyre iniciativave, pasi praktika tregon se motivimi dhe rezultatet humbasin në veprimet afatshkurtra.

4.5.3 Ekzistimi i bashkëpunimit me nëpunësit tjerë të rëndësishëm në nivelin lokal në fushën e zhvillimit të multikulturalizmit

Përvojat janë të ndryshme, dhe disa nga organizatat e përfshira në anketim shprehin pakënaqësi për shkallën e angazhimit të qeverisë lokale për të bashkëpunuar me organizatat e shoqërisë civile në promovimin e të drejtave të bashkësive etnike në komunë, veçanërisht në aspektin e komuniteteve me pak përfaqësim. Pakënaqësia u shpreh kryesisht në mungesën e interesit për t'u këshilluar organizatat e shoqërisë civile për çështje që prekin komunitetet më të vogla etnike.

4.5.4 Frekuenca dhe cilësia e komunikimit ndërkulturor midis komuniteteve

Nga anketimi i qytetarëve mund të konstatohet se marrëdhëniet në përgjithësi perceptohen në një nivel bashkëpunimi dhe bashkëjetese paqësore, ndërsa një përqindje e vogël e qytetarëve nga komunitetet e pakicave në komunë, deklaruan se marrëdhëniet ndërkomunitare janë abstenuese. Pamja mbizotëruese midis maqedonasve dhe turqve është se marrëdhëniet kanë mbetur të pandryshuara në vitin e fundit, ndërsa shumica dërrmuese e shqiptarëve besojnë se ato po përmirësohen. Rreth gjysma e pjesëmarrësve nga të gjitha komunitetet deklaruan se ata kanë komunikim dhe bashkëpunim të përditshëm në të gjitha fushat me komunitete të tjera, ndërsa për gjysmën tjetër këto janë të kufizuara me komunikimin në vendin e punës. Distanca etnike midis një pjese të vogël të të anketuarve ekziston përse i përket të jetuarit në një lagje etnike heterogjene, ndërsa sa i përket mundësisë së martesave etnikisht të përziera, është më e theksuar te bashkësitë më të vogla, siç janë serbët dhe romët.

Kur u pyetën për respektimin e të drejtave të bashkësisë etnike së cilës i përkasin shqiptarët dhe maqedonasit, ata shprehen kënaqësi relative, ndërsa qytetarët turq raportuan ndjeshëm më pak kënaqësi.

Përgjigjet e qytetarëve të etnisë maqedonase mbeten të njëjta në lidhje me çështjen e respektimit të të drejtave të bashkësive tjera në komunë. Është interesante se qytetarët shqiptarë më pak pajtohen me këtë pikëpamje dhe më shumë se gjysma mendojnë se të drejtat e bashkësive tjera respektohen në një farë mase ose shumë pak. Të anketuarit turq përgjithësisht besojnë se të drejtat e bashkësive të tjera respektohen më shumë sesa të drejtat e komunitetit të tyre. Shumica e të anketuarve nga të gjitha grupet etnike deklaruan se besojnë se vetëqeverisja lokale ka një ndikim pozitiv në përmirësimin e marrëdhënieve ndërmjet bashkësive etnike. Rreth një e katërta e të anketuarve maqedonas dhe

turq dhe rreth 15% e të anketuarve shqiptarë konsiderojnë se pushteti vendor nuk ka asnjë ndikim në këtë fushë.

Është interesante të theksohet se KMNB-të sipas qytetarëve të anketuar kanë më pak ndikim pozitiv në marrëdhëniet etnike - shumica e qytetarëve nga të gjitha komunitetet mendojnë se ky organ nuk ka ndikim ose ka një ndikim të keq.

Qytetarët janë të ndarë në këndvështrimin për ndikimin e institucioneve arsimore në marrëdhëniet etnike. Ndërsa të anketuarit maqedonas dhe turq përgjithësisht besojnë se institucionet arsimore i përmirësojnë marrëdhëniet ndëretnike, për qytetarët shqiptarë këto institucione nuk ndikojnë ose përkeqësojnë marrëdhëniet ndëretnike.

Në përgjithësi, qytetarët e të gjitha etnive kanë një perceptim pozitiv për ndikimin e institucioneve në fushën e kulturës mbi marrëdhëniet ndëretnike.

Shumica e qytetarëve besojnë se sektori i biznesit ka një ndikim pozitiv në marrëdhëniet ndëretnike. Sidoqoftë, rreth 40% e të anketuarve shqiptarë deklaruan se ky komunitet nuk ka asnjë ndikim në këtë fushë.

Të anketuarit nga të gjitha etnitë shprehën një perceptim pozitiv në lidhje me ndikimin e organizatave civile në marrëdhëniet ndëretnike.

Të anketuarit kishin pikëpamje ndryshe për ndikimin e partive politike dhe mediave. Sa i përket pyetjes se me cilin komunitet tjetër ndihen më të afër, maqedonasit i konsiderojnë serbët më të afërt, të ndjekur nga shqiptarët, turqit dhe më së paku nga të gjithë romët.

Shqiptarët konsiderohen më të afërt me turqit, të ndjekur nga maqedonasit, romët dhe më pak serbët.

Turqit i konsiderojnë maqedonasit dhe shqiptarët njëlloj të afërt, të ndjekur nga romët, dhe më pak serbët.

4.6 PËRFUNDIMI: INDEKSI I VLERËSIMEVE DHE REKOMANDIMET

Komuna e Gostivarit	5
Pushteti vendor dhe aksesit në shërbimet publike	4,8
Respektimi i normave për respektimin e të drejtave të bashkësive etnike	5
Autoritetet lokale dhe institucionet publike punojnë në mënyrë aktive për të promovuar multikulturalizmin në nivelin lokal	4
Sigurohet qasje e barabartë dhe cilësore në shërbimet publike për qytetarët e bashkësive të ndryshme etnike	6
Ekziston bashkëpunim me nëpunësit tjerë në fushën e promovimit të multikulturalizmit	4
Integrimi dhe ndërtimi i kompetencave ndërkulturore brenda sistemit arsimor	5,2
Respektohet korniza normative për mësimdhënie me nxënës nga bashkësi të ndryshme etnike	7
Aplikimi i qasjes së arsimit ndër-etnik të Integruar	4
Frekuenca dhe cilësia e veprimtarive mësimore multi-etnike dhe veprimtarive jashtëshkollore	5
Zbatimi i programeve për promovimin e multikulturalizmit	6
Angazhim për zhvillimin e kompetencave ndërkulturore midis nxënësve në procesin mësimor	4
Kultura	4,7
Ekzistimi i institucioneve / organizatave të përkushtuara për promovimin e multikulturalizmit përmes kulturës	5
Frekuenca dhe cilësia e ngjarjeve / veprimtarive / projekteve kulturore për nxënës	4
Bashkëpunimi ndërmjet organizatave / institucioneve në fushën e kulturës dhe nëpunësve tjerë lokalë në fushën e promovimit të multikulturalizmit	5
Shoqëria civile dhe kohezioni social	5,3
Angazhimi për projekte / aktivitete për promovimin e multikulturalizmit	6
Frekuenca e aktiviteteve për promovimin e multikulturalizmit	6
Ekzistimi i bashkëpunimit me nëpunësit tjerë të rëndësishëm në nivelin lokal në fushën e zhvillimit të multikulturalizmit	5
Frekuenca dhe cilësia e komunikimit ndërkulturor midis komuniteteve	4

Komuna e Gostivarit ka një traditë disa-vjeçare të marrëdhënieve paqësore ndërkomunitare. Sidoqoftë, ndërtimi i marrëdhënieve të bashkëpunimit dhe bashkëjetesës ndërkulturore përfshin një proces të vazhdueshëm të inkurajimit të njohjes, pranimit dhe shkëmbimit të ndërsjellë. Në këtë drejtim, është e nevojshme të forcohet roli i pushtetit vendor dhe organeve të tij si një palë e rëndësishme në nivelin lokal. Zhvillimi i multikulturalizmit në nivelin lokal duhet të trajtohet si prioritet dhe ky aspekt gjithashtu duhet të merret parasysh kur përcaktohen politikat lokale

që nuk ndikojnë drejtpërdrejt në marrëdhëniet ndërkomunitare në komunë. Prioritet i veçantë janë aktivitetet që synojnë përfshirjen më të madhe të komuniteteve më të vogla në komunë, me distancë më të madhe sociale dhe pakënaqësi për shkallën e përfshirjes së tyre.

Pas kësaj, është e nevojshme të theksohet nevoja për të fituar mundësi për përfshirje kuptimplote të KMNB-së në vendimmarrjen e nivelit lokal. Kjo nuk ka të bëjë vetëm me konsultimin e KMNB për çështje për të cilat ekziston një detyrim i tillë ligjor, por gjithashtu përfshirja e këtij organi në hartimin e planeve, iniciativave, strategjive dhe të ngjashme. Kjo gjithashtu nënkupton një investim të vazhdueshëm në zhvillimin e aftësive të anëtarëve të KMNB-së për t'u angazhuar në fushën e afrimit ndërkulturor, i cili tani për tani është vetëm me iniciativën e palëve të jashtme. Promovimi i rolit të KMNB-së të Gostivarit, si një organ i aftë për të koordinuar dhe iniciuar bashkëpunim ndërmjet palëve të ndryshme të interesit dhe përfaqësimit të të gjitha komuniteteve që jetojnë në komunë do të kontribuojë në shndërrimin e incidenteve dhe iniciativave në projekte të koordinuara dhe të qëndrueshme.

Në këtë kontekst, krijimi i një sistemi të punës, me programe vjetore të punës të përcaktuara, me raporte periodike, si edhe informimin e qytetarëve për aktivitetet e KMNB-së, përmes raportimit në kohë të seancave të mbajtura dhe konkluzioneve të arritura, bashkëpunim të drejtpërdrejtë me qytetarët përmes pjesëmarrjes në seanca. KMNB, duke informuar rreth aktiviteve që do të zbatohen do të kontribuojnë në krijimin e KMNB si një institucion lokal përkatës për promovimin e marrëdhënieve ndërkomunitare.

Në fushën e arsimit, është e nevojshme të braktiset praktika e ndarjes etnike në shkolla. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet përfshirjes së pakicave etnike në komunë, me të cilat u identifikua një distancë e konsiderueshme sociale në sondazhin e qytetarëve dhe në intervistat e palëve të interesuara. Shumë shkolla kanë bërë përpjekje të konsiderueshme ta braktisin këtë praktikë, duke zbatuar aktivitete jashtëshkollore për kohezionin ndëretnik dhe ndërtimin e kapaciteteve të stafit mësimdhënës. Sidoqoftë, këmbëngulja e një praktike që minon themelet e integritit ndëretnik në arsim është një kusht që për një pjesë të konsiderueshme të të rinjve krijon një pengesë artificiale për njohjen dhe kohezionin e ndërsjellë. Në këtë drejtim, nevojitet mbështetje më e madhe për institucionet arsimore në komunë për të rritur shpeshësinë dhe cilësinë e aktiviteve të kohezionit ndëretnik. Përkatësisht, është e nevojshme të krijohen kushte për organizimin e veprimtarive të përbashkëta mësimore që do të shndërrojnë këto nisma nga veprime që kërkojnë kohë, të cilat shihen si barrë si nga nxënësit ashtu edhe nga stafi mësimor, në aktivitete që do të jenë një mundësi për të rinjtë, për mësimin e ndërsjellë dhe afrimin përmes interesave të ndërsjella. Përveç mbështetjes së nevojshme, është e nevojshme të krijohet një sistem për monitorimin e zbatimit të

këtyre aktiviteteve, rezultatet e tyre dhe ndikimin e përgjithshëm në marrëdhëniet mes nxënësve. Kjo do të mundësojë një koordinim më të mirë të aktiviteteve dhe, rrjedhimisht, do të krijojë kushte për një efektivitet më të madh në përpjekjet për të arritur të rinjtë të afrohen me bashkësi të ndryshme etnike.


Duke pasur parasysh që disa nga këto aktivitete zbatohen si detyrime nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, si pjesë e aktiviteteve të projektit që përfshijnë shkolla, ky monitorim dhe vlerësim i këtyre aktiviteteve mund të organizohet në nivel lokal nga sektori i arsimit ose nga një komision i ngritur nga institucionet arsimore në komunë.

Komuna ka ngritur një sektor qytetar që punon në mënyrë aktive për të promovuar bashkëjetesë dhe komunikim ndërkulturor midis komuniteteve të ndryshme. Këto organizata kanë një bashkëpunim të suksesshëm të ndërsjellë, por gjithashtu gëzojnë një bashkëpunim të kënaqshëm me faktorët lokal dhe kombëtar. Përfundimi kryesor që doli përmes diskutimeve me përfaqësuesit e shoqërisë civile është se ndikimi i këtyre iniciativave është shpesh i kufizuar në kohëzgjatjen e tyre të shkurtër, kështu që është e nevojshme të sigurohen kushte për zhvillimin e veprimeve që do të kenë një ndikim sistematik dhe të qëndrueshëm në komunitet. Komuna tashmë po shfaqet si partner mbështetës për të paktën një iniciativë rinore. Një bashkëpunim i tillë duhet të fillohet edhe në fushën e marrëdhënieve ndëretnike. Për më tepër, nuk është më pak e rëndësishme të zhvillohet bashkëpunim me nëpunësit që veprojnë në mjedise me strukturë të ndryshme etnike të popullatës, veçanërisht nëpunësit nga komunat me përbërje etnike përgjithësisht homogjene. Përkatësisht, pikëpamja që është përsëritur shpesh në biseda me bashkëbiseduesit është se paragjykimet lindin si rezultat i paditurisë së Tjetrit dhe se marrëdhëniet midis bashkësive etnike në përgjithësi ndryshojnë dukshëm nga ato kur komunitetet ndajnë të njëjtin komunitet lokal. Mundësia për ta njohur kulturën e njëri-tjetrit nga afër dhe për të pare dallimet kulturore do të mundësojë një shembje më të suksesshme të barrierave dhe distancave midis komuniteteve që janë larg nga njëra-tjetra.

5 KOMUNA E VRAPÇISHTIT

Komuna e Vrapçishtit ndodhet në pjesën veriperëndimore të vendit në rajonin e Pollogut. Vrapçishti është një komunë multi-etnike ku sipas regjistrimit të vitit 2002 në Vrapçisht ka 1,041 maqedonas, 21,101 shqiptarë, 3,134 turq dhe 123 qytetarë të përkatësishë tjetër.¹¹

Struktura etnike e popullsisë në komunën e Vrapçishtit



¹¹Zyra Shtetërore e Statistikave, baza e të dhënave MAKSTAT.

Figura 4. Shpërndarja etnike e popullsisë në vendbanimet e komunës së Vrapçishtit.¹²



¹²Burimi: Harta demografike e Komunës së Gostivarit në Maqedonisht:https://mk.wikipedia.org/wiki/%D0%9E%D0%BF%D1%88%D1%82%D0%B8%D0%BD%D0%B0_%D0%92%D1%80%D0%B0%D0%BF%D1%87%D0%B8%D1%88%D1%82%D0%B5#/media/%D0%9F%D0%BE%D0%B4%D0%B0%D1%82%D0%BE%D1%82%D0%B5%D0%BA%D0%B0:Ethnic_groups_of_Vrap%C4%8Di%C5%A1te_Municipality.svg. Kërkojmë ndjesë por hartat demokrafike ekzistojnë vetëm në gjuhën maqedone dhe është I pamundur intervenimi mbi to.

5.1 VETËQEVERISJA LOKALE DHE QASJA DERI TE SHËRBIMET PUBLIKE

5.1.1 Respektohet korniza normative për respektimin e të drejtave të bashkësive etnike

Komuna e Vrapçishtit u themelua në vitin 1996 dhe më vonë u përfshi në komunën e Negotinës, si një komunë e përbashkët dhe e vetme që shtrihet në territorin e ish-komunave të Vrapçishtit dhe Negotinës. Komuna drejtohet nga një kryetar komune dhe një këshill me 19 anëtarë - përfaqësues të të gjitha komuniteteve në komunë.

Komuna e Vrapçishtit ka tre gjuhë zyrtare, si maqedonisht, shqip dhe turqisht. Megjithëse Komuna e Vrapçishtit nuk ka asnjë detyrim ligjor të krijojë një Komision për Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive, një komitet i tillë u krijua në vitin 2006 dhe përbëhet nga 6 anëtarë, secila me dy përfaqësues nga tre bashkësitë më të mëdha etnike në komunë. Një nga aktivitetet më domethënëse të KMNB-së së Vrapçishtit, në të kaluarën ka të bëjë me kontributin e futjes së gjuhës turke si gjuhë e tretë zyrtare në komunë.

5.1.2 Autoritetet lokale dhe institucionet publike punojnë në mënyrë aktive për të promovuar multikulturalizmin në nivelin lokal

Si pjesë e bashkëpunimit me sektorin e shoqërisë civile, Komuna ka përgatitur dhe miratuar një dokument strategjik me një plan veprimi për promovimin e mirëkuptimit multikulturor, i cili është i vlefshëm deri në vitin 2017. Bashkëbiseduesit nuk na ofruar informata mbi shkallën sa janë arritur objektivat e strategjisë, as nëse është planifikuar të ndiqen veprime strategjike nga pushteti vendor në fushën e promovimit të marrëdhënieve ndër-etnike në komunë.

5.1.3 Sigurohet qasje e barabartë dhe cilësore në shërbimet publike për qytetarët e bashkësive të ndryshme etnike

Brenda bashkisë operon ndërmarrja publike "Vrapçisht" me qendër në fshatin Dobridoll, e cila merret me mirëmbajtjen dhe furnizimin me ujë të pijshëm të popullatës në komunë. Gjatë intervistave me bashkëbiseduesit nuk u identifikuan barrierat për qasje të barabartë në shërbimet e qytetarëve të komunës.

5.1.4 Ekziston bashkëpunim me nëpunësit tjerë në fushën e promovimit të multikulturalizmit

Bashkëbiseduesit nga sfera të ndryshme shprehen të kënaqur me shkallën e bashkëpunimit me autoritetet lokale. Sidoqoftë, kur bëhet fjalë për iniciativa për promovimin e multikulturalizmit, duhet të theksohet se ky bashkëpunim kryesisht

kryhet me institucionet arsimore në komunë, dhe në një masë më të vogël me faktorë tjerë.

5.2 INTEGRIMI DHE NDËRTIMI I KOMPETENCAVE NDËRKULTURORE NË KUADËR TË SISTEMIT ARSIMOR

Arsimi bazë në komunën e Vrapçishtit zbatohet në katër shkolla fillore dhe një të mesme:

- shkolla fillore "Mehmet Derala" në fshatin Gradec
- Shkolla fillore "Naim Frashëri" në fshatin Negotinë
- Shkolla fillore "Vrapçisht" në fshatin Vrapçisht
- Shkollën fillore "Sali Lisi" në fshatin Dobërdoll

Brenda komunës ekziston edhe një shkollë e mesme, shkolla "Negotinë", ku mësimi zhvillohet në gjuhën shqipe, si dhe kopshti "Pranvera", ku funksionojnë grupe në gjuhën shqipe, maqedone dhe turke.

5.2.1 Respektohet korniza normative për aktivitete mësimore me nxënës nga bashkësi të ndryshme etnike.

Në shkollën fillore "Vrapçisht" mësimi zhvillohet në tri gjuhë, si: maqedonisht, shqip dhe turqisht. Kjo është shkolla e vetme në komunë në të cilën mësimi zhvillohet në më shumë gjuhë. Për shkak të shpërndarjes etnike të popullsisë në vendbanime kryesisht etnike homogjene, mësimi në shkolla të tjera zhvillohet vetëm në gjuhën shqipe ose maqedone.

5.2.2 Frekuenca dhe cilësia e veprimtarive mësimore multi-etnike dhe aktiviteteve jashtëshkollore

Nga diskutimet me përfaqësuesit e komunës por edhe me stafin e shkollës theksuan nevojën për një bashkëpunim më të madh të shkollave brenda komunës. Bashkëpunimi me shkolla nga komunat tjera në vend, siç janë Kavadarci dhe Bogdanci, është krijuar si pjesë e Projektit të Arsimit të Integruar të implementuar nga MASH dhe USAID, por bashkëbiseduesit theksuan se një bashkëpunim i tillë është i nevojshëm edhe në vendet tjera në komunë, në mënyrë që nxënësit nga komunitete të ndryshme ku jetojnë së bashku edhe të punojmë së bashku, që të kenë më shumë mundësi për t'u takuar dhe bashkëvepruar. Për më tepër, fondet e ndara për realizimin e një kohezioni të tillë ndër-etnik brenda shkollave u vlerësua si simbolik - larg nga sa janë të mjaftueshme për të pasur një ndikim thelbësor.

5.2.3 Prania e distancës sociale në sistemin arsimor

Megjithëse bashkëbiseduesit në përgjithësi shprehën kënaqësi për marrëdhëniet midis nxënësve nga bashkësi të ndryshme etnike, ata megjithatë deklaruan se ata mendojnë se mund të përmirësohen, sepse barrierat ekzistojnë.

Përveç kësaj, është vërejtur se vitet e fundit, dhe veçanërisht në vitin shkollor 2018/2019, banorët maqedonas fëmijët e tyre i kanë regjistruar në shkollat fillore të qytetit të Gostivarit, dhe jo në komunën e Vrapçishtit. Kjo ka zvogëluar numrin e nxënësve në mënyrë drastike dhe vë në dyshim mundësinë e sigurimit të një mësimi cilësor, i cili nuk do të jetë me klasa të kombinuara. Në këtë mënyrë, nxënësit maqedonas janë të privuar nga mundësia për t'u takuar dhe shoqëruar me fqinjët e tyre nga komunitetet e tjera etnike.

5.2.4 Implementimi i programeve për promovimin e multikulturalizmit

Përveç sfidave financiare, janë identifikuar një sërë sfidash të tjera që ndikojnë në sasinë dhe cilësinë e aktiviteteve të afrimit ndërkulturor mes etnive të ndryshme. Mbi të gjitha kjo i referohet kufizimeve hapësinore me të cilat përballen disa shkolla. Shkolla fillore "Naim Frasheri", shkolla e mesme dhe kopshti "Pranvera" ndajnë të njëjtin objekt që ka ndikim në cilësinë e mësimdhënies, si dhe mundësinë për aktivitete të integruara me nxënës të shkollave të tjera.

Komuniteti i biznesit lokal merr pjesë me sponsorizime dhe donacione për nevojat që lidhen me përmirësimin dhe rinovimin e shkollave komunale. Projektet e bashkëpunimit ndëretnik nuk mbështeten. Përfaqësuesit e sektorit të arsimit shprehën një interes të madh për bashkëpunimin në projektet e integritimit ndëretnik dhe bashkëpunimin me organizatat e shoqërisë civile. Pothuajse nuk ka OJQ aktive në komunë.

5.2.5 Angazhimi për zhvillimin e kompetencave ndërkulturore midis nxënësve në procesin mësimor

Në përgjithësi, aktivitete të tilla kryhen herë pas here, por format e aktiviteteve të përbashkëta jashtëshkollore janë më të zakonshme. Nxënësit takohen dhe bashkëpunojnë në festa dhe ditët festive, por kontaktet tjera janë mjaft të kufizuara.

5.3 KULTURA

Në kuadër të komunës ekziston një institucion kulturor - Shtëpia e Kulturës "Shota", në fshatin Negotinë. Pjesa më e madhe e ngjarjeve kulturore në komunë organizohen brenda këtij institucioni.

5.4 SHOQËRIA CIVILE DHE KOHEZIONI SOCIAL

5.4.1 Angazhimi për projekte / aktivitete për promovimin e multikulturalizmit / Shpeshësia e aktiviteteve për të promovuar multikulturalizmin / Ekzistenca e bashkëpunimit me nëpunësit tjerë të rëndësishëm në nivelin lokal në fushën e zhvillimit të multikulturalizmit

Komuna nuk ka sektor aktiv të OJQ-ve. Bashkëpunimi i institucioneve individuale me Organizatat civile, kryesisht bëhet me organizata nga komuna fqinje e Gostivarit dhe komunat tjera.

5.4.2 Frekuenca dhe cilësia e komunikimit ndërkulturor midis komuniteteve

Shumica e të anketuarve pajtohen që gjuha e komuniteteve të tjera duhet të mësohet, megjithatë shumica thonë se kjo duhet të lihet e lire për të zgjedhur. Përderisa të gjithë të anketuarit maqedonas dhe turq mendojnë se kjo duhet të jetë çështje zgjedhjeje, kjo është diçka me të cilën pajtohen gjysma e të anketuarve shqiptarë. Rreth gjysma e të anketuarve jetojnë në lagje etnikisht homogjene. Edhe në këtë rast, marrëdhëniet midis komuniteteve u vlerësuan si marrëdhënie bashkëpunimi dhe bashkëjetesë paqësore, ndërsa një përqindje e vogël e të anketuarve u përgjigjën se ato ishin të përmbajtura.

Sa i përket zhvillimit të marrëdhënieve në vitin e fundit, përgjigjet janë të ndryshme rreth asaj se a kanë mbetur të njëjta ose janë përmirësuar. Një përqindje e vogël e të anketuarve thanë se komunikojnë çdo ditë me komunitetet e tjera në sferën private. Komunikimi i përbashkët kryesisht zhvillohet në vendin e punës, ndërsa për rreth një të pestën e të anketuarve komunikimi është kryesisht për çështje që lidhen me komunën dhe për festa të ndryshme. Për sa i përket përkatësisë etnike dhe të anketuarve, është interesante që askush nga të anketuarit nga grupi etnik maqedonas ose shqiptar nuk ka deklaruar se ata komunikojnë çdo ditë me grupin tjetër brenda sferës private, por që ky komunikim kryesisht zhvillohet në vendin e punës. Shumica e të anketuarve turq, nga ana tjetër, u përgjigjën se bashkëpunojnë çdo ditë me komunitetet e tjera në të gjitha sferat e jetës. Distanca etnike ekziston midis një pjese të vogël të të anketuarve përse i përket të jetuarit në një lagje etnike heterogjene dhe mundësisë së martesave etnikisht të përziera. Distanca më të mëdha u shfaqën mes komuniteteve më të vogla.

Shumica dërrmuese e të anketuarve shprehen të kënaqur me shkallën e respektimit të të drejtave të komunitetit të tyre dhe komuniteteve të tjera.

Të anketuarit zakonisht shprehin kënaqësi për ndikimin e të gjitha institucioneve të anketuara në marrëdhëniet ndëretnike. Kufizim më i madh është shprehur nga të anketuarit maqedonas dhe turq lidhur me ndikimin e sektorit të biznesit (një e treta mendojnë se nuk ka ndikim).

Maqedonasit komunitetin më të afërt e konsiderojnë atë shqiptar, pastaj turk, serb dhe më pak të afërt atë rom romë.

Shqiptarët i konsiderojnë turqët si komunitetin më të afërt, të ndjekur nga maqedonasit, ndërsa romët dhe serbët i konsiderojnë më pak të afërt.

Turqit e konsiderojnë si komunitetin më të afërt atë shqiptar, maqedonas dhe më pak të afërt atë serb dhe rom.

5.5 INDEKSI I VLERËSIMEVE DHE REKOMANDIMET

KOMUNA E VRAPÇISHTIT	4,4
Pushteti vendor dhe aksesit deri te shërbimet publike	5,5
Respektohet korniza normative për respektimin e të drejtave të bashkësive etnike	7
Autoritetet lokale dhe institucionet publike punojnë në mënyrë aktive për të promovuar multikulturalizmin në nivelin lokal	4
Sigurohet qasje e barabartë dhe cilësore në shërbimet publike për qytetarët e bashkësive të ndryshme etnike	6
Ekziston bashkëpunim me nëpunësit tjerë në fushën e promovimit të multikulturalizmit	5
Integrimi dhe ndërtimi i kompetencave ndërkulturore brenda sistemit arsimor	5,2
Respektohet korniza normative për mësimdhënie me nxënës nga bashkësi të ndryshme etnike	7
Aplikimi i qasjes së arsimit të integruar ndëretnik	6
Frekuenca dhe cilësia e veprimtarive mësimore multietnike dhe veprimtarive jashtëshkollore	4
Zbatimi i programeve për promovimin e multikulturalizmit	5
Angazhim për zhvillimin e kompetencave ndërkulturore midis nxënësve brendaprocesit mësimor	4
KULTURA	3
Ekzistimi i institucioneve / organizatave të përkushtuara për promovimin e multikulturalizmit përmes kulturës	3
Frekuenca dhe cilësia e ngjarjeve / projekteve kulturore për kohezionin ndëretnik	3
Bashkëpunimi ndërmjet organizatave / institucioneve në fushën e kulturës dhe nëpunësve tjerë lokalë në fushën e promovimit të multikulturalizmit	3
Shoqëria civile dhe kohezioni social	3,8
Angazhimi për projekte / aktivitete për promovimin e multikulturalizmit	3
Frekuenca e aktiviteteve / projekteve për të promovuar multikulturalizmin	4
Bashkëpunim me nëpunësit tjerë të rëndësishëm në nivelin lokal në fushën e zhvillimit të multikulturalizmit	4
Frekuenca dhe cilësia e komunikimit ndërkulturor midis komuniteteve	4

Rrethanat specifike të imponuara nga struktura demografike dhe shpërndarja etnike e popullatës në komunën e Vrapçishtit krijojnë kushte të veçanta për bashkëveprim ndërmjet qytetarëve. Me përjashtim të fshatit Vrapçisht, shumica e vendbanimeve në komunë janë etnikisht homogjene, me një përqindje të vogël të komuniteteve më të vogla. Kjo nënkupton që mundësitë kryesore për bashkëveprim ndëretnik përfshijnë fshatin Vrapçisht dhe qendrën e komunës, si dhe fshatin Negotinë. Për sa i përket përpjekjeve të qeverisjes vendore për të promovuar marrëdhëniet ndëretnike, kjo bëhet kryesisht përmes procesit arsimor, i cili i kufizon këto nisma në një segment të popullatës.

Për sa i përket arsimit, të gjitha shkollat në komunë janë të përfshira në projektin për integrimin ndëretnik në procesin arsimor i cili është i për tu lavdëruar. Në kuadër të këtij projekti, shkollat kanë krijuar bashkëpunim me shkollat nga komunat tjera në të gjithë vendin. Veçanërisht e rëndësishme është funksionimi i një kopshti me një qasje të zhvilluar për kohezionin ndëretnik të fëmijëve. Sidoqoftë, nevojiten më shumë përpjekje për të promovuar bashkëpunimin midis shkollave në komunë, i cila ende mbetet i pazhvilluar. Kur bëhet fjalë për krijimin e kushteve për njohje të ndërsjellë dhe miqësi midis nxënësve nga komunitete të ndryshme, është e nevojshme të dekurajohet praktika e regjistrimit të nxënësve të etnisë maqedone në shkollat jashtë komunës. Në këtë mënyrë, ata humbasin mundësinë për t'u afruar me bashkëmoshatarët e tyre me të cilët jetojnë së bashku. Autoritetet lokale, në bashkëpunim me shkollat, mësuesit dhe prindërit, duhet të punojnë për të destimuluar këtë praktikë.

Për më tepër, shkollat përballen me një sërë pengesash (hapësinore, organizative, financiare) për të siguruar kushte për aktivitete të shpeshta cilësore për të zhvilluar kompetencat ndërkulturore të nxënësve. Të gjithë nëpunësit e intervistuar në sektorin e arsimit theksuan nevojën për përfshirje më të madhe në projekte të integritit ndëretnik. Në këtë drejtim, rritja e bashkëpunimit me sektorin e shoqërisë civile dhe forcimi i aftësive të institucioneve arsimore për të gjeneruar fonde do të krijojë kushte për ndikim më të madh dhe më të qëndrueshëm në fushën e mbledhjes së të rinjve nga bashkësi të ndryshme etnike. Komuna nuk ka një sektor të zhvilluar të shoqërisë civile, ndërsa vetëm një organizatë operon në fushën e kulturës. Në këtë drejtim, është e nevojshme të forcohet bashkëpunimi midis palëve të interesuara përkatëse në nivelin lokal (qeverisja lokale, shkollat) me organizatat e shoqërisë civile dhe të krijohen kushte të mundshme për zhvillimin e sektorit civil lokal. Është gjithashtu e nevojshme të forcohet roli i KMNB-së si një organ që mund të jetë partner në zhvillimin dhe zbatimin e nismave për të promovuar marrëdhëniet ndërkomunitare.

BIBLIOGRAFIA

Buxheti i Komunës së Tetovës për vitin 2019, I cili është në dispozicion në linkun më poshtë:

<https://www.tetova.gov.mk/docs/buxhet2019m.pdf>

Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" Nr. 5, 29 Janar 2002).

Ligji për Organizimin e Territorit të Vetëqeverisjes Lokale në Republikën e Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" Nr. 55/2004, 12/2005, 98/2008 dhe 106/2008).

Të dhëna nga Zyra e Statistikave Shtetërore, baza e të dhënave MAKSTAT.

Statuti i Komunës së Gostivarit, i cili është në dispozicion në linkun më poshtë:

<http://gostivari.gov.mk/mk/%d1%81%d1%82%d0%b0%d1%82%d1%83%d1%82-%d0%bd%d0%b0-%d0%be%d0%bf%d1%88%d1%82%d0%b8%d0%bd%d0%b0-%d0%b3%d0%be%d1%81%d1%82%d0%b8%d0%b2%d0%b0%d1%80/>

6. SHTOJCA 1. LISTA E INSTITUCIONEVE TË KONTAKTUARA PËR NEVOJAT E HULUMTIMIT

Komuna e Tetovës

1. Përfaqësues nga Komuna e Tetovës
2. Komisioni për Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive - Tetovë
3. Qendra e Kulturës – Tetovë
4. Shkolla Shtetërore e Muzikës – Tetovë
5. SH.F „Kirili dhe Metodij “ – Tetovë
6. SH.M „Moshë Pijade“ - Tetovë
7. OJQ “ Birs” – Tetovë
8. OJQ „Loja “– Tetovë

Komuna e Bërvenicës

1. Përfaqësues nga Komuna e Bërvenicës
2. Komisioni për Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive - Bërvenicë
3. OJQ për mbrojtje nga zjarri e Komunës së Bërvenicës
4. NPK „Vardar “ – Bërvenica
5. SH.F „Goce Dellçev “, fsh. Stençe
6. SH.F „Koço Racin“, fsh. Bërvenicë
7. SH.F „7 Marsi“, fsh. Cellopek

Komuna e Gostivarit

1. Përfaqësues nga Komuna e Gostivarit
2. N.P „Pyjet e Maqedonisë“ Gostivar
3. N.P „Komunalec“ Gostivar
4. Galerija „Kult“ Gostivar
5. SH.F „Goce Dellçev“ Gostivar
6. Sh.M „Gostivar “
7. OJQ Qendra për rini – Gostivar
8. OJQ Nisma e Integritetit Qytetar
9. OJQ „Meseçina “

Komuna e Vrapçishtit

1. Përfaqësues nga Komuna e Vrapçishtit
2. Kopshti „Pranvera “
3. Sh.F „Naim Frashëri “, fsh. Negotinë
4. Sh.f „Vrapçisht “, fsh. Vrapçisht
5. Përfaqësues nga komuniteti i biznesit

